

ZGJEDHJET PARLAMENTARE DHE PARTITË POLITIKE NË
SHQIPËRI (1921-1923)

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I HISTORISË

NGA

SEAD PANTINA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

NËNTOR, 2022

REZYME E TEMËS SË DIPLOMËS PËR NIVELIN MASTER

Mentori: *Prof. Asoc. Dr. Selim Bezeraj*

Kandidati: *Sead Pantina*

Tema: *Zgjedhjet parlamentare dhe partitë politike në Shqipëri (1921-1923)*

Qëllimi i këtij studimi është trajtimi i temës: "Zgjedhjet parlamentare dhe partitë politike në Shqipëri (1921-1923)", dhe synimi për të paraqitur një pasqyrë të qartë të zhvillimeve politike në shtetin shqiptar në fillim e dekadës së tretë të shekullit XX. Janë shtjelluar në mënyrë të duhur ngjarjet politike, ushtarake e diplomatike siç janë: dy kongreset kombëtare si ai i Durrësit (1918) dhe Lushnjës (1920), paraqitjen e partive dhe grupeve politike, çlirimin e Vlorës dhe hinterlandit të saj, zgjedhjet politike të vitit 1921 dhe 1923, formimin e qeverive dhe pjesëmarrësit e tyre e shumë gjëra të tjera. Duke u munduar të i shtjellojmë këto ndodhi, kjo temë, sjellë të dhëna të shumta statistikore, lëvizje e fryma të ndryshme politik të paraqitura në atë kohë në shtetin shqiptar etj..

Në fillim të këtij punimi është bërë grumbullimi i literaturës adekuate dhe janë bërë hulumtime të tjera lidhur me literaturën relevante për temën bosht të çështjes së shtruar për studim. Ndërsa më pas ka ndodhur strukturimi i temës, e që në këtë aspekt, tema është e ndarë në 3 kapituj dhe në disa nënkapituj të cilave u paraprijnë: abstrakti, parathënia (ku shpjegohen qëllimet, metodat, pyetjet hulumtuese dhe hipotezat), lista e fotove, grafikave e shkurtesave dhe hyrja.

Kapitujt kanë këtë përmbajtje strukturore:

- Në kapitullin e parë të titulluar: "**THEMELIMI I PARTIVE POLITIKE DHE FUNKSIONIMI I TYRE NË SHTETIN SHQIPTAR**", është trajtuar në formë të zgjeruar organizimi, zhvillimi dhe vendimet e rrymat politike në Kongresit të Lushnjës; ndodhitë politike ushtarake deri në prag të zgjedhjeve parlamentare; dhe vend me rëndësi i është kushtuar zgjedhjeve parlamentare dhe çdo gjë që lidhej me to, si ligji zgjedhor, partitë politike pjesëmarrëse, programet politike të këtyre partive, organizimi dhe rezultati i zgjedhjeve.

- Në kapitullin e dytë të titulluar: "**ZHVILLIMET POLITIKE (1921-1923) DHE ZGJEDHJET PËR ASAMBLE KUSHTETUESE NË SHTETIN SHQIPTAR**", janë trajtuar një sërë çështjesh që nga qeveria e parë e dal nga zgjedhjet parlamentare; pastaj koalicioni parlamentar "Bashkimi i Shenjtë" e qeveria e këtij koalicioni; grusht shteti i dhjetorit të vitit 1921; kryengritja e marsit 1922; ndërrimet e qeverive; pastaj debatet rreth zgjerimit të Statutit të Lushnjës e paraqitja në pika të shkurta i Statutit të Zgjeruar të Lushnjës; dhe njësoj sikurse në kapitullin paraardhës edhe në këtë kapitull ka zënë një vend me rëndësi dhe mjaft vëmendje zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese, duke u paraqitur ligji zgjedhor, grupet politike pjesëmarrëse dhe programet politike të tyre, organizimi e rezultati zgjedhor; dhe në nënkaptullin e fundit janë trajtuar ngjarjet politike që ndodhen gjatë vitit 1924.
- Në kapitullin e tretë të titulluar: "**STATUTET E PARTIVE POLITIKE NË SHQIPËRI (1920-1924)**", janë trajtuar disa statute të grupeve politike që ekzistuan në këtë periudhë në shtetin shqiptar, siç janë statuti i "*Degës Nacionaliste*" me qendër në Elbasan dhe statuti i partisë "*Nacional-Demokrate*", ku përpos paraqitjes së tyre jemi munduar që të i analizoj dhe krahasojmë sado pak.

Në punimin e kësaj teme sa i përket metodave hulumtuese janë përdorur metodat kualitative dhe kuantitative. Ndërsa për të finalizuar janë përdorur metodat analitike dhe krahasimore. Dhe duhet përmendur në fund se për realizimin e këtij punimi janë shfrytëzuar një sërë burimesh arkivore të cilat janë marr nga Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH), burime arkivore të botuara, literaturë e bollshme dhe e rëndësishme etj., me të cilat është arritur poashtu që të vendoset saktësia apo pasaktësia e hipotezave të ngritura më parë të cilat i kam paraqitur që në parathënie, e të cilat po i pasqyroj:

1. Zgjedhjet parlamentare të vitit 1921 dhe ato për Asamble Kushtetuese në vitin 1923 ishin pluraliste.
2. Në zgjedhjet e para shqiptare pati ndikime nga jashtë mbi rezultatin në mënyrë që të vinin në pushtet njerëz të afërt me ato vende apo fuqi.
3. Shteti shqiptar, gjatë kësaj periudhe pesë vjeçare (1920-1924), nuk pati zhvillim ekonomik të qëndrueshëm për shkak të mos qëndrueshmërisë politike që mbretëronte.